Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Komora inženjera Republike Kosovo
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo
Njesia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: OIRK
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 332/2026
Nr. i faqeve / Br. Stranica / Nr. Pages: 1
Data / Datum / Date: 20.05.2026
PRISHTINË / A No.1

**ODA E INXHINIERËVE**
**TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Nr. 14-BD/2026
Prishtinë: 19.05.2026

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17 të LIGJIT NR. 08/L–012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 8 paragrafi 2 nënparagrafi 2.10 dhe nenit 24 paragrafi 1 nënparagrafi 1.18 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokolli 8648/24; në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 19.05.2026, nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, projektin e realizuar gjatë vitit 2025 dhe vlerësimin e bërë në përputhje me procedurat dhe kriteret e miratuara nga Bordi Drejtues për përzgjedhjen e "Inxhinierit të Vitit 2025", shpallet "Inxhinieri i Vitit 2025" z. Zijadin Guri.
2. Me mirënjohje shpërblehet znj. Donika Bajrami Mustafa, për kontributin dhe angazhimin profesional në profesionin e inxhinierisë në fushën e ndërtimit.
3. Ky vendim nxirret me qëllim të promovimit të profesionit të inxhinierit, vlerësimit të kontributit profesional dhe promovimit të cilësisë në fushën e ndërtimit.
4. Lista e vlerësimit e Bordit Drejtues i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i dërgohet:*

- *Komisionit Mbikëqyrës.*
- *Anëtarëve Themelues të Odës.*
- *Arkivit të OIRK-së.*

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca,** Kryetar i OIRK-së ____________________
2. **Mimoza Shahini,** Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
3. **Kadri Morina,** Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
4. **Afrim Demiri,** Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
5. **Nebi Pllana,** Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
6. **Bujar Jupaj,** Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
7. **Sami Kolgeci,** Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________

**LISTA E VLERËSIMIT**
**PËR PËRZGJEDHJEN E "INXHINIERIT TË VITIT 2025"**

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të kandidatëve, projektet e realizuara gjatë vitit 2025 dhe vlerësimin e bërë nga Bordi Drejtues në përputhje me procedurat dhe kriteret e miratuara për përzgjedhjen e "Inxhinierit të Vitit 2025", kandidatët janë vlerësuar si në vijim:

1. Zijadin Guri – 76.83 pikë
2. Donika Bajrami Mustafa – 63.43 pikë
3. Heset Hajdini – 40.71 pikë
4. Besim Abrashi – nuk kualifikohet për vlerësim, pasi aplikimi është bërë me botim libri, i cili nuk hyn në kategoritë dhe kriteret e përcaktuara për vlerësim sipas procedurave të miratuara nga Bordi Drejtues.
5. Adil Shatri – nuk kualifikohet për vlerësim, pasi projekti me të cilin ka aplikuar është përfunduar gjatë vitit 2024 dhe nuk i përket periudhës së vlerësimit për "Inxhinierin e Vitit 2025".
6. Rasim Mjekiqi – nuk kualifikohet për vlerësim, pasi projekti inovativ me të cilin ka aplikuar është ideuar dhe zhvilluar para vitit 2025 dhe nuk i përket periudhës së vlerësimit për vitin 2025.
7. Njomza Haliti – nuk kualifikohet për vlerësim, pasi projekti me të cilin ka aplikuar kërkon licencë të kategorisë A, ndërsa kandidatja posedon licencë të kategorisë B, në kundërshtim me kriteret dhe kërkesat profesionale të përcaktuara me legjislacionin dhe aktet përkatëse në fuqi.